


“Feniksi kosova...” dhe “Dy mon...”  
 janë: “Irredentisti...” dhe “Dy mon...”  
 Realizime filmiko-televizive: “Tradita” (1978), “Dora e ndihm...”  
 (1989), “Peripeçitë e Lecit” (1991), etj.  
 Publicistikë: Letra të hapura dërguar: Sllobodan Millosheviqit  
 shkronjat”, Dobrica Qosiqit, Millan Paniqit, xhaxhallarëve të bo...  
 Nekro(bër)llogu për Vasa Çubrilloviqin etj.  
 Gjatë këtyre njëzet vjetëve, Qemajl Sokoli është marrë edhe  
 kritikë, fejtunistikë dhe publikime të ndryshme nga lëmi i teatrit dhe film...  
 etj. Pas okupimit të TVP-së, jeton vepron dhe krijon në Mitrovicë.

**Ali D. Jasiqi**  
**TUBËS KATËRSTINËSHE**

**Katër libra të Tahir Jahës, botoi “Jeta e re”, Prishtinë, 1995**

Në botim të revistës letrare “Jeta e re”, këto ditë dolën nga shtypi katër libra (“Tymon oxhaku i Sadik Micanit”, “Bukën në lis çerdhën në shkrepë”, “Mos prek në strajcë të fukarasë” dhe “Pa mirëseardhje, pa tungjatjeta”) të shkrimtarit të gjallë më të vjetër ndër ne, Tahir Jaha. Secili nga këta libra mund të qëndrojë në vete, por ata përbëjnë një tërësi, në të cilën është dhënë historia e një familjeje, e cila personifikon një fshat, një krahinë dhe një komb, e shkruar nga një autor me përvojë të gjatë jetësore e letrare, që i ka shënuar me kujdes e përkushtim të gjitha bëmat



karakteristike që e cilësojnë këtë “histori”. Katër libra një që bëjnë, tërësi të mbështetur në katër pika karakteristike, katër çështje, sa reale, aq edhe enigmatike do të shkruajë autori në fillim të librit të parë, në hyrjen që e pagëzoi “Në vend të parathënies”.

Megjithatë, duhet thënë se lënda e dhënë në këta katër libra nuk është as kronikë e thjeshtë, as ditar për bëmat e familjes Micani, që duket se është vetë familja e Tahir Jahës. Sepse, aty nuk gjejmë as data e as vite të shënuara, por këto të dhëna janë prezente përmes shkrimit të ngjarjeve që zhvillohen, përmes përshkrimeve e “komentimeve” që u bën autori atyre, nga të cilat lexuesi nuk e ka vështirë të kuptojë se në cilën periudhë, në cilën etapë të zhvillimit ka ndodhë kjo apo ajo ngjarje.

“Ngjarjet” e librit të parë të Tahir Jahës ndodhin para luftës së fundit, atëherë kur micanët luftonin edhe kundër mbretit me aq fishek sa kishin në grykën e pushkës. Me largimin e turkut nga këto troje vijnë pushtuesit tjetër, si sllavë, që përkundër luftërave të pandërprera kundër tij, nga të cilat veçojmë edhe resitencën e kaçakëve të koncentruar në “Zonën Neutrale” të Junikut, që përfshinte edhe fshatin e lindjes së Jahës, mungonte përkrahja ndërkombëtare. Prandaj Slavoja shtron torturat dhe mundimet kundër popullit autokton, me qëllim të përzënies së tij nga trojet atnore dhe kolonizimin me ardhasakë. Slavoja, emër ky që e ndeshim edhe në librat e tjerë, ngjarjet e të cilëve ndodhin shumë më vonë, është përfaqësuesi tipik i pushtuesit sllav, që mund të ndërrojë lëkurën, por nuk e harron zanatin, siç thotë populli, prandaj sa herë që i vie rasti e tregon fytyrën e vet të vërtetë prej lakeji.

Në librin e dytë të kësaj tërësie Tahir Jaha trajton temën e luftës çlirimtare, duke treguar për heroizmat e djelmohave trima e vashave trimëresha të kombeve të ndryshme, që qëllim të përbashkët kishin përzënien e okupatorit fashist nga këto troje. Ky qëllim dhe ky orientim kishte bërë që luftëtarët të “harrojnë” përkatësinë e tyre kombëtare dhe të luftojnë kundër armikut të përbashkët. Prandaj, nënë Ziza e pranon Gjorgjin në shtëpi si djalë të vetin në një anë e Suta tregon trimëri të pashoqe në anën tjetër. Tahir Jaha edhe vetë pjesëmarrës aktiv në luftën çlirimtare, siç e cilëson ai, i përshkruan me përkushtim heroizmat e partizanëve, i bindur se as në këtë luftë nuk ishin tradhtuar interesat kombëtare, të paktën nga shqiptarët me bindje të plotë për luftën e drejtë që po zhvillonin.

Derisa dy librat e parë kemi pasur rastin t'i lexojmë edhe më herët (një fragment i romanit është botuar shumë më herët në revistën letrare "Jeta e re"), kur në vitin 1988 Tahir Jaha doli para lexuesve me romanin "Tyton oxhaku i Sadik Micanit", dy librat tjerë janë shkruar më vonë dhe janë vazhdim i dy librave të parë, por që e përcjellin fatin dhe bëmat e familjes së micanëve në kushte e rrethana të reja të krijuara nga ndryshimet shoqërore, historike. "Në domosdonë e krijimit të Frontit Çlirimtar më ishte treguar dyshimi ndaj thikës pas shpine, kurse ndaj vendësve që shtireshin si engjëj, por t'i linin këmbët e arushës në dorë... do të më dridhej dora sikur t'i godisja me gurë para se t'u jepja bukë me dorë në zemër. Mbase po t'i vriste buka ime nuk do t'u jepja bukë me dorë në zemër. Mbase po t'i vriste buka ime nuk do t'u gjendej ilaç për ndërgjegjen e prishtë të tyre". Në anën tjetër "Slavoja nersente çakejt". Një rrjedhë fatzezë, për të gjetur ndonjëfarë zgjidhje u bë vazhdë gjaku e quajtur SHPËRNGULJE. Po shpërngulja e shqiptarëve nga trojet e veta, ku do të silleshin sllabojasit e jugut".

Nga citatet e nxjerra nga libri i tretë mund të kuptohet lehtë se fjala është për mashtrimin që u ishte bërë shqiptarëve pas luftës. Përkundër ndonjë përmirësimi të kushteve të jetës që u ishte ofruar shqiptarëve pas luftës, ndër të cilat vlen të veçohet shkollimi në gjuhën amtare, ishin ndërmarrë edhe disa aksione që nuk ndryshonin nga ato të paraluftës për vështirësimin e qëndrimit të tyre në trojet etnike, aty ku i kishin lindur e jetuar gjyshërit e stërgjyshërit, ndër të cilat veçohet ai për shpërnguljen për në Turqi dhe aksionit të grumbullimit të armëve, që duhej t'i shërbente planit të ndërrimit të strukturës etnike të popullsisë në këto troje. Dhe jo vetëm kaq. Atyre u bëheshin edhe presione më të ndryshme më perfide, të arsyetuara me kushedi sa faktorë, që as mund të qëndronin nga të cilat Tahir Jaha, si ilustrim të qëlluar dhe mjaft simbolik shënon aksionin e zhdukjes së dhive, që në popull është njohur si lopa e fukarasë.

Po citojmë edhe një pasues nga librat e Jahës për të ilustruar gjendjen e shqiptarëve pas luftës.

"Më rroku një shqetësim tronditës kur bashkudhëtari im më tha se kishte hetuar që bukës i vinte era mejt. E kryekujdestari, ashtu llapsur tha: Grurin e kemi ble prej Stojanit... dikush si nën faj pohoi: "Varrezat e lashta pranë shtëpisë së ardhacakut, i kishin LAVRUAR KOLONËT, andaj grurit i vie era mejt".

Librin e katërt dhe të fundit Tahir Jaha, megjithatë e përfundon me një optimizëm dhe shpresë, se:

“Megjithatë në vrapin për të gjetur “përfillim katër fletësh” Slavoja kurthohet në rrënjët e madergonjës, duke humbur pusullën ashtu “PA MIRËSEARDHJE, PA TUNGJATJETA”, do të thotë ashtu siç ke ardhur edhe do të shkosh nga toka dhe vendi i huaj.

Idenë dhe preokupimin e vet për këtë vepër letrare Tahir Jaha e kishte paralajmëruar qysh më parë në vjershat e botuara, qoftë në shtyp apo edhe në përmbledhjen e poezive “Lulet e stinëve” (“Rilindja” 1967). Kjo ide dhe ky preokupim është rrumbullakuar dhe e ka marrë formën e vet të prerë në katër librat në shqyrtim, që nuk janë as kronika e as ditar për bëmat e familjes së mianëve. Madje, ky nuk është as roman historik, në kuptimin klasik të fjalës. Historia dhe ngjarjet e ndryshme të zhvilluara në kohë dhe hapësirë të caktuar atij i shërbejnë vetëm si pikënisje për shtruarjen e lëndës së romanit, në të cilin mungon fabula në kuptimin klasik të romanit. Ngjarjet në vepër nuk mungojnë, por Tahir Jaha ndjek rrugën më shumë të komentimit të tyre, se sa të përshkrimit, prandaj veprën e tij mund ta quajmë edhe si roman-komentues, për të mos thënë bashkëkohor dhe modern.

Katër librat e Tahir Jahës, siç u tha edhe më lart, përbëjnë një tërësi, një roman më të gjatë. Megjithatë, autori i ka nda në katër pjesë, ose siç i quan ai në “Tubëz katërstinëshe”, nis nga periudhat që trajton secili veç e veç. Si të tilla ata edhe mund të qëndrojnë si tërësi në vete, që rrumbullakojnë një periudhë e tërësi organike. Madje edhe kapitujt, të cilëve autori u ka vu tituj të veçantë, japin një tërësi, si tregime që e plotësojnë njëri-tjetrin, për të krijuar kështu një vepër shumëdimensionale me vlera të theksuara artistike, ngase Tahir Jaha ka aftësi të rrallë të të vërejturit dhe të seleksionimit të atyre elementeve esenciale për një çështje apo problem që shtrohet në vepër.

Gjuha me të cilën janë shkruar katër librat e Tahir Jahës meriton një studim të veçantë. Është kjo gjuha e Malësisë së Gjakovës me të gjitha karakteristikat e së folmës së saj, por e ngritur në një gjuhë të unisuar letrare, duke i ruajtur shprehjet e saj dalluese, që vërehen përmes anekdotave aforizmave, urtive, që shkrihen për mrekulli në vepër dhe nga e cila del e gjithë filozofia, botëkuptimi dhe përvoja jetësore e njerëzve, nga e cila, trevë është vjelë lënda për veprën e Tahir Jahës, për katër librat e tij. Nga citati i nxjerrë dhe i dhënë në mbështjellësin e librave”... secili i ka

zhelet e veta, por më zhyli është ai që mban se të huajat janë më të pasura",  
lë të kuptohet se kemi të bëjmë me një krijues që di të shtratëzojë për  
mrekulli gjuhën e pasur të ambientit nga e cila e vjel lëndën e veprës në  
fjalë.

ROMAN

**DESKRIPSIONI SI PROCEDIM**

Tahir Jaha: "Tymon oxhaku i Sadik Micanit", botoi "Rilindja",  
Prishtinë, 1988



Tahir Jaha me bashkëshorten Hajrie  
Jaha me rastin e promovimit të librit  
"TYMON OXHAKU I SADIK MICANIT"

formë e shprehjes që disi del jashtë kornizave dhe rezultateve të gjinisë  
përkatëse. Çka e kushtëzon një refleksion të këtyllë?

*Fati që përsëritet historikisht*

Romani "Tymon oxhaku i Sadik Micanit", edhe si tematikë edhe si  
prosedë, mbetet disi jashtë tendencave të pranishme stilistike e tematike të  
prozës sonë. Sintagmën stilistike-tematike e kuptojmë si përkufizim të asaj  
që nënkupton përpunimin stilistik të një tematike specifike. Romani i Tahir

Në prozën tonë nuk janë të rralla  
rastet kur ndonjë botim i ri, ndonjë vepër  
e veçantë, apo krijim letrar i një forme  
më të vogël të na duket se është  
rundiment i një dukurie të tejkaluar, një  
prirje letrare apo pikëpamje të tillë mbi  
artin letrar. Rastet e tilla zakonisht në  
aktin e akseptimit sikur krijojnë parabola  
me kohët përkatëse, me periudhat kur ai  
krijim letrar do të dukej se është  
prodhim i kushteve dhe rrethanave  
socio-historike e kulturore. Një mbresë  
të ngjashme e kemi edhe nga romani  
"Tymon oxhaku i Sadik Micanit" të

Tahir Jahës. Pikërisht ky roman na duket  
se është rundiment, prodhim letrar në  
një kohë tjetër ia dhuroi kohës sonë,  
një kohë tjetër ia dhuroi kohës sonë,  
një kohë tjetër ia dhuroi kohës sonë,  
një kohë tjetër ia dhuroi kohës sonë.

Jahës është shembull ilustrativ për një problematikë që e ndeshëm, fjala vjen, në kohën kur u shfaq romani “Njerëzit” i Hivzi Sulejmanit dhe “Rrushi ka nis me u pjek” i Sinan Hasanit. Pikërisht analogjia me romanin e Hivziut është më e madhe, ngase kemi disa përkime ideo-tematike. Edhe njëri e edhe tjetri trajtojnë fatin e njeriut tonë të paraluftës, pozitën e tij gjatë LNÇ-së dhe statusin e tij të pasçlirimit. Në romanin e Tahir Jahës “Tymon oxhaku i Sadik Micanit”, ndiqet fati i një familjeje fshatare, asaj që fillet i ka diku buzë Erenikut, kurse në fund të romanit i ofrohet qytetit. Fati i kësaj familjeje është i atillë sa duket se është e predestinuar për flijim: ajo i reziston me shumë viktima regjimeve të shumta mbretërore, pastaj edhe okupuesve italianë e gjermanë dhe pas shumë flijimesh përjetojnë që edhe pas çlirimit statusi i tyre socio-historik të mos zgjidhet. Pikërisht nga kjo përfolje e shkurtër të fabulës mund të fiksohen edhe analogjitë e planit ideor me romanin “Njerëzit” të Hivzi Sulejmanit. Që të dy romanet na bëjnë me dije një gjë, fati i njeriut tonë bëhet historikisht i përsëritshëm.

Romani “Tymon oxhaku i Sadik Micanit” sajohet nga dy pjesë, dy tërësi kompozicionalisht dispartate. Pjesa e parë si tematikë dhe si procedim ka mjaft dallime nga e dyta. Në të vija dominante fabulative është ajo e fatit të familjes së Micanëve gjatë sundimit të regjimeve të ndryshme antipopullore të periudhës së paraluftës. Autori përmes një procedimi kryekrejt deskriptiv manipulon me dije dhe fakte që lidhen me biografinë e Sadik Micanit, duke e vështruar atë në planin historik (lidhjet me traditën dhe jetën kanunore) dhe planin social (rezistimi ndaj shtypësve, të cilët vazhdimisht e kanosin ekzistencën e tij. Në rrëfim zakonisht dominon forma komentuese edhe evokative që shfaqet përmes projektimit të një vetëdije qendrore, të cilën mund ta konsiderojmë si vetëdije të narratorit të gjithëdijshëm. Karakteristikë e kësaj vetëdijeje është animi permanent dhe intenca për theksimin e asaj që është pozitive, duke e shprehur në të njëjtën mënyrë qëndrimin negativ, ndaj së keqes. Rrëfimtari i tillë, prandaj, shpesh e më shpesh te mbresa se është i sforcuar, rrëfimin që përshkruan sipas një skeme të caktuar. Pjesa e parë e romanit edhe e ka si efekt dominues deskripsionin, jo atë deskripsion që do të ishte rezultat i përshkrimit sinkronik të eksterierit apo enterierit, por është përshkrim i plasazheve të tëra tokësore, të cilat e zvogëlojnë apo edhe e mbulojnë në tërësi syzheun. Deskripsioni i këtillë, shikuar në planin funksional, do të mund të quhej në njëfarë mënyre edhe si “cistë teksore” (Hamon), sepse nuk e përlligj

gramatikën e narracionit dhe logjicitetin artistik me të cilin duhet të zhvillohet syzheu. Rrëfimi romanësor, posaçërisht i pjesës së parë, është i ngopur frazeologjizmash, të cilët shpeshherë sikur mbesin të paharmonizuara me një kontekst rrëfimor të një shkalle të lartë abstraksioni. Këto frazeologjizma, s' di për ç' arsye, romancieri zakonisht i jep të vëna në thonjëza.

Pjesa e dytë e romanit gjithsesi se është artistikisht më e arrirë. Arsyet e cilësisë duhet kërkuar së pari në përfilljen më të madhe të logjikës së rrëfimit realist, ku, ndonëse pranë mbizotëron deskriptioni, megjithatë fitohet mbresa se qëllimi është të arrihet, siç do të thoshte Barti, efekti më i madh i realitetit, sepse edhe autori merret me probleme të drejtpërdrejta të jetës dhe ato i shfaq me një diskurs përshkrues.

### **Idea mbi ngadhënjimin e së mirës**

Në këtë pjesë të romanit, për dallim nga pjesa e parë, autori e zbulon një horizont të ri: familja, Micani nga një pozitë e rrezikimit social e ekzistencial kalon në një shkallë tjetër: vetëdijesimi klasor e historik. Familja Micani, e cila këtë personazhin kryesor, Sadik Micanin, e zëvendëson me Sokolin (Blinin) dhe me personazhet e tjera, të cilat profilit tradicional të malësorit, që e shquan Sadik Micanin ia shtojnë edhe atë revolucionar.



*Ymer Pula, Nahire Surroi, Drita Dobrosi, Jak Mita, Zeliha dhe Xhafer Byci – çast nga promovimi*

Kjo pjesë e romanit gjithsesi se dallohet për praninë e një syzheu të mirëfilltë, i cili është më i funksionalizuar se sa në pjesën e parë. Edhe rrëfimi tejet i personalizuar, që, siç thamë, shprehej për një vetëdijeje që kryekreje intimizonte gjërat, objektet e fenomenet, herë duke e dhënë qëndrimin emocional të tij e herë atë vlerësues, në pjesën e dytë të romanit sikur dominon një rrëfim më i depersonalizuar, sepse më në fund

konstruksioni syzheik dhe plani preferencial janë mbizotërues ndaj predispozitave për deskripsin e këtij shkrimtari.

Në fund, të themi edhe ndonjë ide lidhur me mbarimin e romanit, përkatësisht përmbylljen e tij me kapitullin "Madërgona u kosit, rrënjët mbetën". Dersia pjesa e parë e romanit në tërësi mund të merret i një prolog, funksioni i të cilës është të nxjerrë dhe të paraqesë perspektivën prej nga do të rrëfejë, çka do të rrëfejë, pjesa fundore vjen si një prolog: fati i familjes Micani përsëritet. Ideja mbi ngadhënjimin e së mirës ruhet, tradita shprishet, sepse brenda një mentaliteti tradicional fshatar, gjithnjë depërtojnë ndikimet nga qyteti, botëkuptimi urban dhe filozofia e burokracisë, e cila është ngadhënjimtare ndaj asaj tradicionale. Pikërisht përmbyllja e këtillë, e cila vjen si nyje e tretë e rrëfimit romanësor, na bëhet se është perspektiva qenësore, e së cilës mbase është dashur t'i jepetj më së shumti forcë.

*R. Musliu*

## LEKSIKONI I VOGËL I SHKRIMTARËVE TANË

### TAHIR JAHA

Poet, novelist e dramaturg, Tahir Jaha lindi më 13 mars 1913 në Babaj të Bokës, afër Gjakovës, në një familje të varfër fshatare. Qëkur ishte fëmijë, familja e tij kaloi në Shqipëri, ku Tahiri e kreu shkollën fillore të Krumës (1925) e një kohë i vijoi mësimet edhe në Gjimnazin e Shkodrës. Por, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike të familjes, i ndërpreu mësimet dhe filloi të punonte për kafshatë të gojës.

Më 1942 u kthye në Kosovë dhe menjëherë u vu në lidhje me organizatën e Partisë Komuniste të Jugosllavisë në Prizren e mori pjesë aktive në Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Pas çlirimit të Prizrenit (1944) u bë komisar i Komandës së Vendit e i Komandës së Qarkut e pastaj sekretar i Këshillit Popullor të Rrethit (1945-1947). Në periudhën 1947-1948 ishte sekretar i Komitetit të Rrethit të PKJ në Dragash, ku kreu edhe detyrën e Këshillit Popullor të Rrethit. Më 1948-1950 ishte i besuar i Shëndetësisë dhe i Asistencës Sociale i Këshillit Popullor Krahinor të Kosovës, e pastaj pasi e kreu shkollën e mesme të Partisë në Prishtinë (1951) u bë drejtor i Shtypshkronjës "Miladin Popoviq" në Prishtinë (1951-1956). Pasi shërben edhe një kohë si i besuar i Shëndetësisë dhe i Asistencës Sociale të Këshillit



Popullor të Rrethit të Prishtinës (1956-1960) kalon me detyrë në Kryqin e Kuq të Kosovës (1960-1982), ku ushtron funksionin e sekretarit ose të kryetarit të Këshillit Krahinor derisa doli në pension. Edhe pas pensionimit është aktivist i shquar i Kryqit të Kuq dhe i organizatave të tjera politiko-shoqërore të Krahinës dhe të Komunës së Prishtinës.

Për letërsi interesohet qëkur ishte nxënës. Por nisi të shkruajë në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare. Nga ajo kohë kanë mbetur të shkruara vjershat: "Zani i kushtrimit" e "Me dy teha" (1943), "Ereniku" (1944), poema "Çlirimtarët" (1943-44), tregimi "Tymon oxhaku i Sadik Micanit" ("Jeta e re", 1/1964), të gjitha të botuara pas luftës në të përkohshme të ndryshme dhe në librin e Isak Shemës "Gjurmë të përflakura" nga krijimtaria letrare e publicistika e Luftës Nacionalçlirimtare në Kosovë (1941-1945), e botuar më 1976 nga Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës (Prishtinë, 1976). Nga ajo kohë kanë mbetur edhe vjershat "Suta trime", "Pa titull" etj., gjithashtu, të botuara në të përkohshmet tona pas luftës dhe në vëllimin e poezive të Tahir Jahës "Lulet e stinëve", që e botoi Redaksia e botimeve të "Rilindjes" (Prishtinë, 1967).

Pas luftës shkruan vjersha, tregime e drama, e më rrallë merret edhe me publicistikë, duke shkruar kryesisht për çështje shoqërore e humanitare. Vjershën e parë pas luftës "Çarshafi" ("Morali nuk ruhet me sy mshelur") e botoi në gazetën "Rilindja" më 1949, e pastaj bashkëpunon me "Zërin e rinisë", "Jetën e re" e revista e gazeta të tjera në gjuhën shqipe në Jugosllavi. Për tekstin e parë dramatik "Eja, eja...", të shkruar më parë si njëaktëshe e pastaj edhe dyaktëshe, pati fituar shpërblimin e revistës letrare "Jeta e re" (1958), e cila pos në faqet e revistës, e botoi këtë dramë edhe si vëllim separat. Redaksia e botimeve e "Rilindjes", më 1968 ia botoi edhe dramën në dy akte "Dialog kohe", e cila, bashkë me dramën "Eja, eja..." u luajt në shumë skena amatore në Kosovë e në qendra të tjera. Në programin e Radio Prishtinës u emituan si radiodrama "Dialog kohe" dhe "Sofra e vëllazërisë", e cila nuk është botuar si tekst, por të cilën autori është duke e përgatitur si dramë për inskenim teatror. Pos kësaj, sipas informatave që morëm nga autori, ai është duke përgatitur një përmbledhje të tregimeve dhe të tregimeve satirike ("Bujrum bukë, kulturë e barot", "Mos prek në strajcën e fukarasë" etj.) që ka në dorëshkrim ose të botuara në të përkohshmet tona, kurse sipas novelës së botuar "Tymon oxhaku i Sadik Micanit" ka shkruar romanin në dy pjesë, të cilin është duke e përgatitur për botim.

Pjesëmarrës aktiv në Luftën Nacionalçlirimtare Tahir Jaha shumë shpesh edhe është frymëzuar nga kjo luftë dhe është përpjekur ta pasqyrojë atë dhe figurat e ndritshme të saj në punimet e veta artistike, të botuara ose që ka ende në dorëshkrim. Pos në revista e gazeta, ai është përfaqësuar edhe në disa përmbledhje e botime antologjike të letërsisë shqipe në Jugosllavi si në vëllimet “Shtigjeve të qëndresës” e “Stazama otpora” (1961) me vjershën “Te rrahu i përgjakur”, në “Panoramë e letërsisë bashkëkohore shqipe në Jugosllavi” (1964) me një fragment të dramës “Eja, eja...”, e cila është botuar në tërësi edhe në librin “Drama shqipe” (Beograd, 1965), pastaj në përmbledhjen e vjershave për fëmijë “Këndo, vëlla” (1966), në librin “Nën Çabrat, Gjakova” (1978) e tjera.

Për veprimtari të pasur në jetën shoqërore-politike, kulturore e sidomos humanitare, Tahir Jaha, është bartës i shumë mirënjohjeve, plakatave e dekoratave, në mesin e të cilave edhe i Mirënjohjes së Nëntorit të qytetit të Prishtinës, i Shenjës së artë dhe i medaljes për punë humane të Kryqit të Kuq të Jugosllavisë e të republikave e të krahinave, i plaketave federative të Lidhjes së Shoqatave të Luftëtarëve të LNÇ të Jugosllavisë e i plaketës për mbrojtje civile etj.

Përpos këtyre, Tahir Jaha edhe nga Kryetari i RSFJ është dekoruar me disa dekorata të larta, midis të cilave edhe me Urdhrin e Vëllazërim - Bashkimit të rendit II, Urdhrin e Punës me flamur të kuq, Urdhrin e Meritave për Popull të rendit II etj.

*Vehap Shita*

**Në përvjetorin e vdekjes përkujtohet kryetari i nderit të  
Kryqit të Kuq të Kosovës  
ZBULOHEK BUSTI I TAHIR JAHËS**

Tahir Jaha kontributin e tij në Kryqin e Kuq e ka zhvilluar prej dy dekadash dhe gjatë kësaj periudhe jo vetëm ka ndihmuar njerëzit, por ka bërë një punë të madhe në angazhimin e të rinjve në Kryqin e Kuq, tha Xhevat Shkodra.

Pjesëmarrës të shumtë, vullnetarë të Kryqit të Kuq të Kosovës, familja, miq e dashamirë të kryetarit të nderit të Kryqit të Kuq të Kosovës Tahir Jahës të mërkurën në Prishtinë në përvjetorin e vdekjes kanë zbuluar bustin e tij. Në ceremoninë e zbulimit të bustit të Tahir Jahës, janë evokuar

kujtimet më të mira për të. Tahir Jaha sipas Xhevat Shkodrës kryetar i Kryqit të Kuq të Kosovës ka dhënë një kontribut të madh jo vetëm me punën humanitare të zhvilluar në Kryqin e Kuq të Kosovës, por edhe veprimtarinë e tij letrare, e cila prej të pranishmëve është cilësuar si e arrirë.

“Tahir Jaha kontributin e tij në Kryqin e Kuq e ka zhvilluar prej dy dekadash dhe gjatë kësaj periudhe jo vetëm ka ndihmuar njerëzit, por ka bërë një punë të madhe në angazhimin e të rinjve në Kryqin e Kuq”, tha Shkodra.

Për kontributin e tij dhënë në Kryqin e Kuq të Kosovës, Tahir Jaha pas luftës



*Çast nga zbulimi i bustit*

sipas Shkodrës është shpallur kryetar nderi i Kryqit të Kuq të Kosovës.

Edhe ministrja e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, ka folur fjalë miradije për kryetarin e nderit të KKK-së dhe ka veçuar sidomos veprën e tij letrare të cilën tha se e mban me kënaqësi në bibliotekën e saj.

“Kam pasur fatin që ta njoh për së afërmi dhe mund të them se karakteri i tij i përputhet shumë misionit që e ka Kryqi i Kuq i Kosovës”, tha ajo. Vetima Jaha, e bija e Tahir Jahës, e emocionuar që në oborrin e zyrave të Kryqit të Kuq të Kosovës po zbulohet busti, tha se falënderon shumë KKK në që pas luftës me aktivitete të ndryshme ka nderuar punën e babait të saj. “Sot zbulimi i këtij busti për familjen tonë është një përjetim i veçantë, sepse ashtu siç mbeti i pavdekshëm për familjen, i pavdekshëm mbeti edhe për Kryqin e Kuq”, tha Vetima.

Në ceremoni është thënë se për veprimtarinë e tij në Kryqin e Kuq, Tahir Jaha nuk ka mbetur pa u ndëshkuar nga regjimi serb, por me një vetëmohim të pashoq sipas tyre ia ka arritur të bëjë shumë jo vetëm për ata që kanë nevojë por edhe për Kosovën. Është thënë po ashtu se veprimtaria e tij duhet të jetë shembull për të gjithë ata që bëjnë vepra humanitare.

Familja Jaha përveç bibliotekës personale që ia kanë dhuruar Kryqit të Kuq të Kosovës, i ka dhuruar edhe 50 pako me ushqime për familjet skamnore të cilat do t'i shpërndajë Kryqi i Kuq i Kosovës.

*B. K.*